



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr. 03-364

24.11.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë, neni 19 i Rregullores për mbrojtjen e të miturve(fëmijëve) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.172/14), pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3349/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4325/2 datë 23.11.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 38-të mbajtur më 23.11.2023, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për shkeljen e kryer të nenit 50 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe të nenit 19 të Rregullores për mborjetjen e të miturve (RRMPM), të mënyrës që në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, më 9 gusht 2023 janë transmetuar më shumë programe artistike pa u shënuar me sinjalistikën për mbrojtjen e të miturve(fëmijëve) para fillimit dhe gjatë kohës së transmetimit të tyre.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3349/1 datë 01.09.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike sipas kërkesës, si dhe të pakove programore që i ritransmetojnë operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekt i respektimit të dispozitave të Ligjit në fjalë, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masën – aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur është krye cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejet dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 50 paragrafi (1) të LSHMAAV, radiodifuzerët nuk duhet të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve (fëmijëve), në veçatin program me përmbajtje pornografike ose dhunë e tepruar. Ofruesit e shërbimeve, sipas kërkesës, duhet të ndërmarrin masat më të rrepta teknike për të siguruar se të miturit (fëmijët) janë të mbrojtur nga këto përmbajtje siç janë dhunë e tepruar dhe pornografi. Përveç programeve nga paragrafi (1) i këtij neni, programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, duhet të sigurohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele kështu që të miturit nuk do të mund në kohë të zakonshme t'i dëgjojnë ose shohin programet. Kur programet transmetohen ose reprizohen në formë të pakoduar, ofruesi i shërbimit mediatik audiovizual është i obliguar para transmetimit të tyre të siguron paraprakisht paralajmërim akustik dhe mundësi për tu identifikuar me ndihmën e shenjave vizuale gjatë gjithë transmetimit të programeve. (neni 50 paragrafi 3 të LSHMAAV).

Në nenin 19 të RRMPM parashikohet se sinjali paralajmërues duhet të aplikohet para fillimit dhe gjatë kohës së transmetimit të programave të shërbimeve programore televizive dhe në vendin e duhur afër programeve të disponueshme në katalogun e shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, dhe atë: në të gjitha llojet e programeve artistike dhe në ato lloje programesh me karakter informativ, edukativ ose argëtues, që në tërësinë ose në pjesë të programit, mund të ndikojnë negativisht tek fëmijët.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 1 shtator 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV GURRA SHPKNJ Kërçovë, transmetuar më 9 gusht 2023, në nivel lokal, ku u konstatua shkelja e nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 19 të RRMPM.

Përkatësisht, me mbikëqyrjen e rregullt programore është konstatuar se në kundërshtim me nenin 19 (aplikimi i sinjalistikës paralajmëruese) të RRMPM, të shërbimit programor televiziv të SHTR TV GURRA SHPKNJ Kërçovë, transmetuar më 9 gusht 2023, pa sinjalistikën paralajmëruese para fillimit dhe gjatë transmetimit janë transmetuar më shumë programe artistike, dhe atë: „Magareshka kozha (Lëkura e gomarit) – Përadha popullore maqedonase“ – programi artistik, „Trojca braqa (Tre vëllezërit) – Përadha popullore maqedonase“ – programi artistik dhe Sha je be tu folën?!“ - serial.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3349/1 datë 01.09.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV GURRA SHPKNJ Kërçovë, më 06.09.2023 ka dërguar Shkresë me Nr.y në ark.10-3349/2 datë 06.09.2023, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3349/1 datë 01.09.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe nga RRMPM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 29.09.2023. Në afatin e parashikuar, SHTR TV GURRA SHPKNJ Kërçovë, nuk ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe nga RRMPM. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 23.11.2023, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që SHTR TV GURRA SHPKNJ Kërçovë, t'i shqiptoi masën – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe neni 19 të RRMPM, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pasthua) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3349/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4325/2 datë 23.11.2023, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe të RRMPM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 23.11.2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR TV GURRA SHPKNJ Kërçovë, dhe obligohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administativ para gjakatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-3349/1 datë 01.09.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në aft prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.